



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Ne bazë të nenit 25, 32, 38 dhe 73 të Rregullores Disiplinore të FBK dhe nenit 40 të Rregullores së Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Propozimit me Ref. Nr. 183 datë 19.5.2015, Propozimin e Komesarit të garave me Ref. Nr. 183 datë 19.5.2015, Raportit e Policisë së Kosovës Ref. Nr. 183/2 të datës 19.5.2015, Raportit të vëzhguesit të ndeshjes të datës 18.5.2015, Deklaratës së gjyqtarit kryesor të ndeshjes z. Ivan Milicevic Ref. Nr. 183/5 të datës 20.5.2015, Deklaratës e gjyqtarit të ndeshjes z. Faton Kurshumliu Ref. Nr. 183/3 të datës 19.5.2015, Raportit të z. Art Gashi, kryetar i KB “Peja” nga Peja Ref. Nr. 183/1 të datës 19.5.2015 Vendimit të Komisionit Arbitrarë me Ref. Nr. 189 datë 26.5.2015 si dhe në bazë të Deklaratës së z. Gazmend Pupovci me Ref. Nr. 207/KD të datës 03.6.2015, Komisioni Disiplinor me datë 04.6.2015 mori këtë:

V E N D I M

- I. Mbetet në fuqi Vendimi me Ref. Nr. 185 datë 21.5.2015 i Komisionit Disiplinor të Federatës të Basketbollit të Kosovë me të gjitha pikat e tij.

Arsyetim

Komisioni Disiplinor me datë 26.5.2015 ka pranuar Vendimin e Komisionit Arbitrar me Ref. Nr. 189 datë 26.5.2015, i cili në pikën C. Të këtij vendimi konstaton, citojmë: “ Pika I e Vendimit të Komisionit Disiplinor Nr. 185 ,që ka të bëjë me diskualifikimin nga garat e mëtutjeshme në ETC Superligë dhe rënie në një rang më të ulët të garave të “KB Peja” dhe pika IV e të njëjtit Vendim që ka të bëjë me masën disiplinore, ndalim i ushtrimit të detyrës në kohëzgjatje prej 1 viti për Z. Gazmend Pupovci i kthehen Komisionit Disiplinor në Rivendosje.”

Komisioni Disiplinor në përbërje të plotë, rishqyrtoi lëndën në fjalë si dhe deklaratën shtesë me shkrim të z. Gazmend Pupovci, përfaqësues zyrtar i ndeshjes KB Peja VS KB Sigal Prishtina (dërguar me email me datë 03.6.2015 – Ref. 207/KD datë 03.6.2015).

Komisioni Arbitrar, në kuadër të arsyetimit të Vendimit të tij, konsideron Vendimin e Komisionit Disiplinor për diskualifikim të KB Peja nga garat e mëtutjeshme të pa ekzaminueshëm nën arsyetimin se Komisioni Disiplinor nuk ka dhënë arsye për faktet vendimtare.

Gjithashtu, Komisioni Arbitrarë ka theksuar se në pjesën arsyetuese të Vendimit të Komisionit Disiplinor nuk është bërë ekzaminimi i provave një nga një dhe të gjitha së bashku.

Komisioni Arbitrar ka kërkuar që të bëhet ndërlidhja e provave si ajo e vëzhguesit të ndeshjes, deklaratës së gjyqtarit kryesor z. Ivan Milicevic me Ref. Nr. 183/5 datë 20.5.2015 dhe deklaratave tjera.

Në vazhdim Komisioni Arbitrar ka konsideruar se nuk është përfillur Neni 23 i Rregullores Disiplinor që ka të bëjë me rrethanat lehtësuese.

Përfundimisht, Komisioni Arbitrarë pretendon se pika IV e Vendimit të Komisionit Disiplinor që ka të bëjë me përfaqësuesin zyrtar të KB Peja është kundërthënëse, ku në këtë pikë z. Gazmend Pupovci i shqiptohet masa disiplinore në ndalim të ushtrimit të detyrës në periudhën prej një viti”.

Komisioni Disiplinor ka rishqyrtuar edhe njëherë të gjitha provat, dëshmitë dhe deklaratat e ofruara nga të gjitha palët e përfshira në këtë rast si dhe me kujdes të shtuar ka analizuar vendimin e Komisionit Arbitrar, me theks të veçantë pikat për rishqyrtim si dhe deklaratën shtesë të z. Gazmend Pupovci, përfaqësues zyrtar i ndeshjes, ndaj të cilit është zhvilluar procedura disiplinore e ngritur nga Komesari i garave.

Në kuadër të kësaj, Komisioni rishqyrtoi dhe analizoi të gjitha aktet normative në fuqi që rregullojnë veprimtarinë e basketbollit në Kosovë, posaçërisht dispozitave që i referohen rastit të KB Peja dhe përfaqësuesit zyrtar të këtij klubi, z. Gazmend Pupovci.

Komisioni Disiplinor ka bërë ekzaminim e provave një nga një dhe të gjitha së bashku, nga gjithë akterët dhe ka bërë ndërlidhjen e tyre në mënyrë kronologjike, si dhe ka konstatuar faktet në vijim për shqiptimin e dënimit të KB Peja nga Peja:

Komisioni Disiplinor, si provë bazë në lidhje me shqiptimin e dënimit si në pikën I të Vendimit me Ref. 185 datë 21.5.2015 të Komisionit Disiplinor ka marrë Nenin 40 të Rregullores së Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës ku thuhet:

“Skuadra e cila pa arsye e braktisë fushën para përfundimit të lojës në ndeshjen e PLAYOFF-it (gjysmëfinale dhe finale) automatikisht diskualifikohet nga garat e mëtutjeshme dhe bie në një rang më të ulët të garave.

Skuadra, e cila pa arsye e braktisë fushën para përfundimit të ndeshjes dhe koha e kthimit për ta vazhduar ndeshjen është më e gjatë se time-out-at që i takojnë në këtë periudhë të ndeshjes apo për çfarëdo arsye që e vlerësojnë gjyqtarët duke i dhënë kohën e arsyeshme prej 15 min për kthim dhe vazhdim të ndeshjes - dënohet me 2.000 euro”.

Në këtë kontekst, si fakt i cili vërteton pa arsyeshmerinë për braktisje të fushës para përfundimit të ndeshjes, me ç’rast Komisioni Disiplinor si bazë ka marrë deklaratën e Gjyqtarit kryesor të

ndeshjes z. Ivan Milicevic, citojmë: "Drugo poluvrijeme; 3 minute prije početka drugog poluvremena moje kolege i ja izlazimo na teren i na kojem se zagrijavaju obe ekipe.

1,30 min do početka drugog poluvremena Ekipe B (Peja) za mene iz nepoznatih razloga napušta teren. Nekoliko trenutaka nakon što je ekipa napustila teren na njemu je se zadržao trener Gostiju (Boris Kurtović). Nakon mog pitanja: Šta se dešava, zašto napuštaju teren? Nije mi znao odgovoriti, Rekao je "Ne znam".

Nakon što je proteklo cca 15 min od trenutka kad je trebalo početi drugo poluvrijeme, kontaktirao sam predsjednika kluba Peja gosp. Art Gashi, koji se u tom trenutku nalazi preko puta zapisničkog stola. Pitao sam ga zašto ne žele da igraju na što mi je odgovorio "da im je policija sugerirala da ne igraju iz sigurnosnih razloga".

U tom trenutku uočavam igrače KB Peja koji se nalaze na ulazu (u tunelu) na košarkaško igralište i krećem prema njima. Na putu prema Igračima KB Peja sa trenerom razgovaram sa 2 Policajca koje sam pitao ima li ikakvih sigurnosnih razloga zbog kojih se utakmica nebi trebala početi, na što su mi odgovorili "Nema".

Kad sam došao kod trenera i igrača, "Boris Kurtović" i dalje nije znao što se dešava i zašto ekipa ne želi da igra. Nakon toga kontaktiram Gazmend Pupovci koji na moje pitanje šta nije u redu odgovara jednostavno "Nećemo da igramo" (dërguar me email me datë 20.5.2015 – Ref. Nr. 183/5) – (përkthimi në gjuhën shqipe si vijon):

"PJESA E DYTË: 1.30 minuta para fillimit të pjesës së dytë, KB Peja, për mua nga shkaqet e panjohura, braktisi fushën. Disa momente pas braktisjes së fushës nga ana e lojtarëve, në fushë ka mbetur trajneri I mysafirëve (Boris Kurtovic). Pas pyetjes sime: çka po ndodh, përse po e braktisin fushën? – nuk ka dit me më dhënë përgjigje, më ka thënë: "**nuk di**".

Pasi që kaluan 15 minuta prej momentit kur është dashur të fillojë loja, kam kontaktuar Kryerën e klubit Peja, z. Art Gashin, I cili në at moment gjendej përball tavolinës zyrtare. E kam pyetur "përse nuk dëshirojnë të luajnë, në çka mu përgjigj – "se Policia Ju ka sugjeruar – "**se Policia Ju ka sugjeruar që të mos luajnë për shkaqe sigurie**". Në at moment kam par lojtarët e Pejës që gjinden në hyrje të korridorit për në fushën e lojës dhe nisem të shkojë te ta. Në rrugën gjer te lojtarët e Pejës së bashku me trajnerin kam biseduar me dy policë të cilët I kam pyetur: "a ka ndonjë shkak të pasigurisë për të cilin ndeshja nuk vazhdohet, ata mu përgjigjën – "**Nuk ka**".

Në lidhje me këtë, Komisioni Disiplinor ka marrë për bazë raportin e z. Art Gashi, kryetar i KB Peja i cili ndër të tjera thotë se, citojmë "KB PEJA dëshiron te njofton basketbolldashesit dhe tifozet e saj se që nga momenti i hyrjes në sallë e deri ne perfundim te pjesës së parë të ndeshjes, ekipa dhe kryesia ishin fyer, kërcnuar e shantazhuar në mënyrën më të keqe. Në përfundim të pjesës së parë disa huliganë kanë kaluar anën e ulseve tona dhe kanë sulmuar zyrtarë të klubit tonë. Pas ketij momenti është arrestuar një anëtar i vjetër i kryesisë, njeherit njeri nder themeluesit e Klubit" (raporti zyrtar i z. Art Gashi i dërguar me email me datë 19.5.2015 – Ref. Nr. 183/1).

Komisioni gjatë shqyrtimit të lëndës ka konstatuar se personi i arrestuar nga Policia e Kosovës nuk figuron në listën e zyrtareve të paraqitur nga KB Peja në ndeshjen në fjalë dhe në këtë rast si bazë ka marrë edhe Raportin e Policisë së Kosovës nga i cili citojmë: "Dua te theksoj qe ne ndeshje Policia e Kosoves ka ofruar siguri maksimale duke mos lejuar asnje provokim apo incident. Ne rastin e poshteshenuar nje person eshte larguar nga fusha per shkak te provokimeve me tifoz. Vendimi i KB Peja per te mos luajtur nuk ka te beje asesi per mos ofrim te sigurise.

Siguria bazuar ne vlersimin e Komandantit taktik ka qene ne nivel dhe nuk ka kerkuar forca shtese. “ (Raport i dërguar me email nga Kapiten Driton Ymeri, Komandat i Policisë së Kosovës, Stacioni Qendra – Prishtinë, me datë 19.5.2015 – Ref. Nr. 183/2). Në këtë Raport, gjithashtu hudhën poshtë arsyet e dhëna në deklaratatën e z. Art Gashi, kryetar i KB Peja, citojmë “*Në këtë rast klubi ka kërkuar nga Policia masa shtesë sigurie për të mos u vënë në rrezik sigurine e ekipës dhe zyrtarëve të klubit Pastaj, me kërkesën e disa zyrtarëve të Policisë së Kosovës ekipa jonë ka qëndruar pranë derës së hyrjes derisa policia të vlersoj sigurinë në sallë. KB Peja çdo herë ka punuar për të mirën e basketbollit dhe do vazhdoj të punoj edhe në të ardhmen, por në momente kur cenohet siguria e ndonjërit prej anëtarëve të klubit ne vepruam si cdo Klub apo institucion, kerkuam masa te shtuara te policise*”.

Arsyetimet për mosparaqitje në fushë të KB Peja bien ndeshë edhe me akteret e tjerë të cilët sipas detyrës zyrtare kanë qenë prezentë në ndeshje. Në këtë kontekst vëzhguesi i ndeshjes në pikë 6 të Raportit të Vëzhguesit konfrimon „*PASE PERFUNDIMIT TE QEREKUT TE DYTE EKIPI I KB.PEJA KA QENE PREZENTE NE PARKET, DHE DERI NE 1.30 MIN PARA FILLIMIT TE QEREKUT TE TRET EKIPI I KB.PEJA ESHTË TERHEKUR NGA FUSHA . PASE PRITJES PREJ 15 MIN DHE PAK KOHES SHTESE EKIPIT TE PEJES I ESHTË TERHEKUR VEREJTA QE BRENDA 5 MIN (SEMAFORI ESHTË LESHUAR KOHA) NESE NUK PARAQITEN NE FUSHEN E LOJES REFERT DO TA PERFUNDOJNE NDESHJEN*“ (Raport zyrtar i ndeshjes nga vëzhguesi Nexhded Hoxha – datë 18.5.2015).

Komisioni Disiplinor konsideron që akterët kompetent për organizmin e ndeshjes, për menaxhimin e situatës, vlerësimin e lojës, ndarjen e drejtësisë dhe kompetentët për ofrimin e sigurisë kanë ofruar fakte dhe dëshmi të mjaftueshme të cilat gjejnë fajtores KB Peja dhe demantojnë pretendimet se mosparaqitja e tyre ne loje lidhet me arsyetimet e tyre për mungesë te sigurisë.

Për matej kjo konfirmohet nga deklarate e Komandantit Taktit Toger Eshref Beqiri, citojmë: “*Per shkak te kesaj qe zyrtari i kryesise se klubit eshte shoqeruar ne stacion, KB Peja ka refuzuar qe te kthehet ne parket edhe pas bindjes se tyre qe te kthehen ne parket Gjyqtaret e Ndeshjes per shkak te kalimit te kohes se parapare ne baze te propozicioneve te garave te FBK-se qe skuadra te paraqitet ne teren e kane perfunduar ndeshjen parakohe*”.

“*Gjate tere kohes nuk ka pasur probleme apo incidente tjera*” (dërguar me email nga Kapiten Driton Ymeri, Komandat i Policisë së Kosovës, Stacioni Qendra – Prishtinë, me datë 19.5.2015 – Ref. Nr. 183/2).

Duke u bazuar ne te gjitha dëshmitë e ofruara rikonfirmohet shqiptimi i masave disiplinore si në Vendimin Ref. Nr. 185 datë 21.5.2015.

Në lidhje me pikën IV të Vendimit me Ref nr. 185 datë 21.5.2015 që ka të bëjë me shqiptimin e masës disiplinore ndaj z. Gazmend Pupovci përfaqësueses zyrtar në ndeshjen në fjalë, komisioni në kuadër të zhvillimit të procedurës disiplinore ka kërkuar edhe një deklaratë shtesë nga z. Pupovci e cila bënë përshkrimin teknik të hyrjes dhe daljes në fushë të ekipit së Pejës dhe arrestimin e një personi të cilën Komisioni e konsideron si jo lëndore ngase i njëjti nuk figuron në listën e zyrtarëve të KB Peja.

SK
ST
HI

Komisioni disiplinore në bazë të mandatit që ka, merr për bazë deklaratën e dhënë nga z. Pupovci që lidhet me vendimin për paraqitje ose mos paraqitje të skuadrës në fushë ku thotë: *“Pese minuta para skadimit te kohes per hyrje ne fushe gjyqtari I pare Milicevic ofrohet dhjete metra nga vendi ku ishim ne dhe me eshte drejtuar mua duke me sinjalizuar se I kemi edhe 5 minuta ne dispozicion per hyrje ne fushe per cka une I a kthej ne gjuhen e tij se une pe kuptoj dhe jame duke punuar ne kthimin e ekipes, por asnjeher nuk I them se nuk do te dalim ne fushe cka e potencoj edhe njeher se ne asnje moment nuk ka qene qellim I yni te mos e vazhdojme ndeshjen. Per kete tregojne edhe pamjet televizive kur ekipi yne hyne ne fushe te lojes pas sinjalit nga policia se tani mund te hyjme ne fushe. Gjate kësaj kohe, Kryetari I Federatës z. Erolld Belegu iu drejtuar Komesarit per te shkuar tek refet me qellim te jepet kohe shtese per 15 minuta, gje e cila nuk u prefill nga gjyqtari I pare Milicevic I cili sinjalizoi perfundimin e ndeshjes”* (deklaratë e dërguar me email me datë 03.6.2015 – Ref. Nr. 207/KD).

Komisioni Disiplinor, konsideron se e gjithë deklarata z. Pupovcit që lidhet me ngjarjen është në shpërputhje dhe e kundërt me deklaratat e akterëve dhe zyrtarëve përgjegjës për zhvillimin e ndeshjes në mes të KB Sigal Prishtina nga Prishtina vs KB Peja nga Peja, se këto veprime bien ndesh me Neni 73 të Rregullores për Procedura Disiplinore të FBK ku thuhet *“Lojtari, funksionari ose trajneri me fajin e të cilit vjen deri te ndërprerja e lojës e cila nuk vazhdohet: Dënohet me ndalesë kohore për lojë ose kryerje të detyrës apo me të holla”*.

Komisioni Disiplinor ka për të detyrë që në bazë të nenit 32 të Rregullores Disiplinore të zhvillojë procedurë disiplinore siç thuhet: *“Procedura disiplinore iniciohet në bazë të fletëparaqitjes të cilën mund ta paraqes secili anëtar i FBK, person zyrtar, organet apo organizatat e FBK, kundër anëtarit të FBK, delegatëve të kuvendit dhe anëtarëve të bordit të FBK- në organet tjera sportive”*.

Komisioni disiplinor në bazë të fletëparaqitjes së Komesarit të garave ka zhvilluar procedurë disiplinore dhe ka marrë për bazë nenin 38 të Rregullores Disiplinore ku thuhet: *“Komisioni disiplinor vendos në bazë të procedurës së zbatuar dhe deklaratave të dhëna nga pjesëmarrësit, të cilat mund të jenë në formë të shkruar apo gojore. Në procedurën disiplinore, komisioni disiplinor vlerëson faktet sipas bindjes së lirë”*.

Në bazë të këtij neni, Komisioni Disiplinor konstaton përgjegjësinë e drejtpërdrejtë për ndërprerje të ndeshjes z. Gazmend Pupovcin i cili si përfaqësues zyrtar dhe shqipton masën disiplinore si në Vendimin me Ref. Nr. 185 datë 21.5.2015 sepse të gjitha deklaratat e akterëve të përfshirë dëshmojnë për faktet përfundimtare për marrje të Vendimit, sikur ajo e gjyqtarit të ndeshjes z. Milicevic, citojmë *“Nakon toga kontaktiram Gazmend Pupovci koji na moje pitanje šta nije u redu odgovara jednostavno “Nećemo da igramo” – përkthimi në gjuhën shqipe si vijon:*

Pas kësaj kam kontaktuar Gazmend Pupovcin I cili në pyetjen time cka nuk është në Rregull, thjesht më përgjigjet:- “Nuk duam të luajmë”. (dërguar me email me datë 20.5.2015 – Ref. Nr. 183/5).

Me teje citojmë deklaratën e Z. Pupovcit *“Une si person zyrtar dhe punëtor sportiv shume vjeçar deklaroj me pergjegjesi te plote se ne asnji moment nuk kemi pasur qellim nderprejen e ndeshjes por kemi kerkuar vetem sqarime dhe masa shtese sigurie”*

Lidhur me këtë, Komisioni Disiplinor mbështet në Raportet zyrtare të organeve të Rendit të cilat janë të thirrura të ofrojnë një gjë të tillë e që në rastin konkret konsiderojmë që vendimi për mosparaqitje në fushën e lojës është i pa bazuar nga ana e z. Pupovci dhe KB Peja në përgjithësi, ngase kushtet e sigurisë konfirmohen të përshtatshme nga Komandanti Taktik Toger Eshref Beqiri, citojmë: *“Per shkak te kesaj qe zyrtari i kryesise se klubit eshte shoqeruar ne stacion KB Peja ka refuzuar qe te kthehet ne parket. edhe pas bindjes se tyre qe te kthehen ne parket Gjyqtaret e Ndeshjes per shkak te kalimit te kohes se parapare ne baze te propozicioneve te garave te FBK-se qe skuadra te paraqitet ne teren e kane perfunduar ndeshjen parakohe”*.

“Gjate tere kohes nuk ka pasur probleme apo incidente tjera” (dërguar me email nga Kapiten Driton Ymeri, Komandat i Policisë së Kosovës, Stacioni Qendra – Prishtinë, me datë 19.5.2015 – Ref. Nr. 183/2).

Komisioni Disiplinor, si rrethanë lehtësuese ka marrë parasysh që KB “Peja” dhe z. Gazmend Pupovci kanë merita sportive dhe përvojë të gjatë në zhvillimin e basketbollit në Pejë, RKS dhe gara ndërkombëtare (BIBL) dhe për këto arsye ka marrë për bazë Neni 25 të Rregullores Disiplinore ku thuhet: *“Rrethanat lehtësuese ekzistojnë kur kryerësi para kundërvajtjes së bërë ka qenë shembull i sjelljes sportive, ose ka përvojë (stazh), me pjesëmarrje ne kombëtare ose merita dhe mirënjohje tjera për zhvillimin e sportit të basketbollit. Pranimi i gabimit nga kryerësi, mund të merret si rrethanë lehtësuese”*.

Lidhur me këtë ndaj KB Peja dhe z. Gazmend Pupovci nuk është aplikuar Neni I i Propozicioneve të Garave për Edicionin Garues 2014/2015 konkretisht *“1.3. Të gjitha klubet pjesëmarrëse në sistemin e garave janë të obliguara t'i lexojnë këto propozicione dhe të bashkëpunojnë me të gjitha organet e FBK-së. Asnjë klub pjesëmarrës në garat e organizuara nga ana e FBK-zë nuk guxojnë nën asnjë rrethanë:*

1.4. Që të refuzojë ndeshjen apo të lëshojë fushën e lojës pa përfunduar ndeshja.

1.5. Që të refuzojë pjesëmarrjen, apo të lëshojë - braktisë, ceremonialin e hapjes, mbylljes apo ceremonialin e shpalljes së fituesit dhe ndarjes së medaljeve dhe dhuratave.

1.6. Që të silltet në mënyrë jokorrekte dhe ofenduese me çka do të ndikojë në zhvillimin normal të garave, funksionet oficiele (zyrtare) të garave apo ceremonive.

Na rast të shkeljes së këtyre dispozitave, Komisioni Disiplinor I FBK-së, me Propozim të Komesarit të Garave, apo organit tjetër të FBK-së, do të shqiptojë dënimin dhe atë:

Diskualifikimi I menjëhershëm dhe ndalesa e paraqitjes në gara në kohë zgjatje prej një (1) sezoni dhe dënimi me para në shumë prej 3.000,00€, si dhe dënimi për personin përgjegjës të Klubit (përfaqësuesi zyrtar apo Kryetari I Klubit)”.

Komisioni Disiplinor vlerëson se Vendimi për kthim në rivendosje nga ana e Komisionit Arbitrar është i pa bazuar duke ju referuar Nenit 10 të Rregullores mbi Punën e Komisionit Arbitrar të FBK-ës ku thuhet: *“Arbitrazha gjatë punës së vet, duhet të vendos në bazë të parimit të çmuarjes së lirë të provave, akteve normative të FBK-ës dhe ligjeve të aplikueshme në Kosovë”*. Komisioni për Arbitrazh ka pasur dispozicion të gjitha dokumentacionin lidhur me rastin, në të cilat është bazuar Vendimi i Komisionit Disiplinor të FBK.

KOSOV
SHTETI

Komisioni Disiplinor konsideron se, për garat kombëtare duhet të merren për bazë aktet normative përkatëse në fuqi të FBK, siç ka rekomanduar Komisioni për Arbitrazh në Vendimin e tij.

Komisioni Disiplinor, pas rishqyrtimit sipas vendimit të Komisionit të Arbitrazhit të FBK, dhe pas administrimit të serishëm të gjitha fakteve dhe dëshmive me të cilat ka disponuar, duke e plotësuar Vendimin sipas kërkesës së Komisionit për Arbitrazh konsideron se vendimi i Komisionit disiplinor Nr. 185 të datës 21.5.2015, është plotësisht i ligjshëm dhe i bazuar në fakte konkrete dhe lidhur me këtë komisionit njëzëri vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë Komisionit Arbitrar në afat prej tri ditësh nga marrja e këtij vendimi.

Komisioni Disiplinor:

1. Fidan HAMITI, kryetar

2. Nuredin IBISHI, anëtar

3. Lulzim FUSHTICA, anëtar



Vendimi t'i dërgohet:

1. KB "Peja" – Pejë,
2. Gazmend Pupovcit,
3. Komesarit të Garave,
4. Arkivit të FBK-së, dhe
5. Anëtarëve të KD.

Kosovo. Basketball Federation Lagja Arbëria, Objekti C2/11, Lokali nr. 4 – 10000 Prishtina ,
Kosovo.
www.basketbolli.com, email: info@basketbolli.com, tel +381 38 70 41 01; mob: 00 386 73 80